



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:123224

Datë: 07.05.2024

Numri i dokumentit: 05670120

KE.nr. 2594/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen juridike të paditësit QT “Eli-Ab” Sh.P.K., me nr. unik identifikues 81104644 dhe me seli në Ferizaj, që sipas autorizimit përfaqësohet nga avokate Nazmije Ibrahimimi nga Ferizaj, kundër të paditurve 1. B.P. nga fshati Pozhoran i Komunës së Vitisë, që sipas autorizimit përfaqësohet nga avokat Burim Islami nga Gjilani dhe 2. Kompania e Sigurimeve “Scardian” me seli në Prishtinë, që sipas autorizimit përfaqësohet nga avokate Violeta Jashari, me objekt kontesti kompensim i dëmit, vlera e kontestit 1,687.40 EUR, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik të datës 24.04.2024 ku prezantuan përfaqësuesit e palëve ndërgjyqëse, me datën 07.05.2024 merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit QT “Eli-Ab” me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri i parë B.P. apo në mënyrë eventuale i padituri i dytë Kompania e Sigurimeve Scardian me seli në Prishtinë, që në emër të dëmit material të shkaktuar me datë 17.08.2016, t’ia paguajnë paditësit shumën prej 1,687.40 EUR, dhe atë me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data e shkaktimit të dëmit me 17.08.2016 e deri në pagesën definitive, në afat prej shtatë (7) ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

1. Çështja gjyqësore dhe pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësi QT “Eli-Ab” me seli në Ferizaj, me datë 15.12.2015 ka paraqitur padi pranë Gjykatës Themelore në Ferizaj kundër të paditurit B.P., me objekt kontesti kompensim dëmi. Ndërsa, në

shqyrtimin gjyqësor të datës 03.03.2019, ka bërë zgjerimin e padisë në aspektin subjektiv edhe ndaj të paditurës së dytë Kompania e Sigurimeve “SCARDIAN”.

Gjykata Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin C.nr. 10/18 të datës 10.12.2019 ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si të pabazuar.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, me aktvendimin Kom.Dh.Shk.II.nr. 28/22 të datës 13.10.2022, ka aprovuar si të bazuar ankesën e paditëses QT “Eli-Ab” ashtu që ka prishur Aktgjykimin C.nr. 10/18 të datës 10.12.2019 të gjykatës së shkallës së parë, dhe lëndën e ka kthyer në rigjykim dhe rivendosje pranë Departamentit për Çështje Ekonomike të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë.

Paditësi, si në padi, ashtu edhe përgjatë seancës përgatitore në rivendosje, ka mbetur në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë duke theksuar se i padituri i parë B.P., me datë 17.06.2016, derisa ka qenë duke vozitur kamionin e firmës “Euro-Fisi” nga drejtimi i Ferizaj për në Gjilan, me pjesën e epërme të rimorkios, ka goditur reklamën e firmës “Eli-Ab” e cila ka qenë e vendosur në një lartësi prej 3.20 metra nga tora, kështu duke i shkaktuar paditësit dëm material në vlerë prej 1,687.40 EUR. Ka shtuar se ndaj të paditurit të parë është zhvilluar procedurë penale, por që me aktvendimin PP./II.nr. 1894-5/16, Prokuroria Themelore në Ferizaj ka hudhur kallëzimin penal në mungesë të dashjes së të paditurit të parë, ndërsa paditësi është udhëzuar në kontest civil. Ka shtuar se i padituri i parë nuk ka paraqitur asnjë provë pranë Prokurorisë Themelore në Ferizaj dhe nuk ka argumentuar pafajësinë e tij dhe përgjegjësinë për evitimin e dëmit ngase i njëjti ne bazë të deklaratës se dhënë ne procesverbalin e datës 06 shtator 2018, deklarate e dhënë 19 ditë pas incidentit, është deklaruar se nuk din çfarë tabela te regjistrimit ka pasur automjeti transportues të cilin e ka drejtuar në ditën kur e ka shkaktuar incidentin gjegjësisht demin material paditëses. Ka shtuar se paditësi, është vënë në dijeni se automjeti të cilin e ka drejtuar i padituri i parë ka qenë i siguruar tek e paditura e dytë vetëm në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 03.09.2019.

Përgjatë shqyrtimit gjyqësor si dhe në fjalën përfundimtare, ka qëndruar pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke theksuar se nga provat e administruara, dhe atë nga shkresat në procedurë penale por edhe nga vet deklarata e të paditurit të parë, vërtetohet legjitimiteti real pasiv i të njëjtit në procedurë, pasi që i padituri i parë ka qenë duke vozitur automjetin me të cilin është shkaktuar aksidenti. Tutje ka shtuar se nga prova e ofruar nga i padituri i parë, konkretisht nga polica e sigurimit, nuk vërtetohet se automjeti me të cilin është shkaktuar aksidenti, është

automjeti të cilin e paditura e dytë e ka siguruar për llogari të firmës “Euro-Fisi” e mbi këtë bazë ekziston përgjegjësia objektive tek e paditura e parë për kompensimin e dëmit material të shkaktuar të paditësit, lartësia e të cilit dëm vërtetohet nga faturat e administruara si provë në këtë shqyrtim gjyqësor. Gjykatës ia ka kërkuar që kërkesëpadia e paditësit në raport me të paditurin e parë të aprovohet si e bazuar, e në rast se gjykata gjen se ekziston edhe përgjegjësia e të paditurës së dytë, atëherë i propozon gjykatës që kërkesëpadia të aprovohet edhe ndaj të paditurës së dytë. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe specifikuar.

I padituri i parë, si në përgjigje në padi, ashtu edhe përgjatë tërë shqyrtimit gjyqësor, e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses duke theksuar se paditësja, ka qenë e njoftuar me kohë se mjeti me të cilin është shkaktuar dëmi ka qenë pronë e kompanisë Eurofisi Sh.P.K., për çka në seancën përgatitore të datës 17.07.2019 paditësja ka marrë obligim që të bëjë zgjerimin e padisë edhe ndaj kësaj kompanie, por një veprim i tillë nuk e ka ndërmarrë, andaj bazuar në nenin 152 të LMD-së i padituri nuk ka legjitimitet real pasiv pasi që lidhur me dëmin e shkaktuar nga punonjësi është përgjegjës personi juridik në të cilin punonjësi ka qenë i punësuar, në këtë rast kompania Eurofisi SH.P.K. Andaj, ka shtuar se i padituri i parë B.P. nuk ka përgjegjësi subjektive deliktore lidhur me dëmin e shkaktuar, ndërsa tutje ka shtuar se nga certifikata e regjistrimit të automjetit me nr. të tabelave ..., dhe konfirmimi i sigurimit i datës 03.09.2019, rezulton se ky automjet është i siguruar nga kompania e sigurimeve KS Scardian. Gjykatës i ka kërkuar që padia e paditësit të refuzohet si e pabazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe specifikuar në shumë prej 912.00 EUR.

I padituri i dytë, si në përgjigjen në padi, ashtu edhe përgjatë shqyrtimit gjyqësor, ka kundërshtuar po ashtu padinë e paditësit duke deklaruar fillimisht se kërkesëpadia e paditësit në raport me të paditurën e dytë është përfshirë në parashkrim, pasi që bazuar në raportin e oficerit të policisë, rasti ka ndodhur me datë 17.08.2016, ndërsa zgjerimin e padisë, e paditura e ka pranuar me datë 07.10.2019, pra më shumë se tre (3) vite nga koha e shkaktimit të dëmit. Tutje ka shtuar se e paditura e dytë nuk ka legjitimitet real pasiv në këtë procedurë, kjo për faktin se nga provat e administruara në këtë shqyrtim dhe atë nga raporti i oficerit policor, nga kallëzimi penal, nga deklarimi i të paditurit të parë pranë Prokurorisë në Ferizaj si dhe nga aktvendimi PP/II.nr. 1894-5/16 i datës 02.11.2018 nuk evidentohet se cili, mjeti, targat dhe numri i shasisë së automjetit me të cilin është shkaktuar aksidenti. Ndërsa, ka shtuar se konfirmimi i lëshuar nga e paditura e dytë me datë 03.09.2019, është bërë me kërkesë të klientit Euro Fisi Sh.p.k, e të cilin konfirmim secili klient mund ta kërkoj, por që nga ky konfirmim nuk vërtetohet se kamioni i

siguruar është pikërisht automjeti me të cilin është shkaktuar aksidenti i datës 18.08.2016. Gjykatës i ka propozuar që padinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

2. Provat e administruara sipas propozimeve të palëve ndërgjyqese

Për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në shqyrtimin kryesor ka bërë administrimin e provave si në vijim: Aktvendimi i Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1894-5/16 i datës 02.11.2017; kallëzimi penal nr. 2016- CF-1949 dt.18.10.2016; procesverbali i deklaramit të të dyshuarit – te paditurit të parë i datës 06.09.2016; raporti fillestar i incidentit 201/CF-1949 dt.18.08.2016 me të cilin janë përfshirë deklaratat e dëshmitarit Arben Shala, raporti i oficerit B. H. dhe fotografitë e bashkangjitura; certifikata e regjistrimit të automjetit me nr. te tabelave ...; konfirmimi i sigurimit i lëshuar nga e paditura KS Scardian dt.03.09.2019; fatura e lëshuar nga Urban Sing Sh.p.k. e datës 07.12.2017; kopja e urdhërpagesës pranë Procredit Bank dt.07.10.2017; kontrata e punës e lidhur ne mes të paditurit të parë dhe Kompanisë Euro Fisi të datës 01.06.2016.

Gjykata pasi ka bërë vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), gjeti se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e bazuar duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi për arsyet si në vijim:

Mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se me datë 17.08.2016 rreth orës 11:40, i padituri i parë B.P., derisa ishte duke vozitur automjetin pronë e kompanisë Euro-Fisi Sh.p.k, nga pakujdesia ka goditur reklamën e paditësit QT Eli-Ab dhe kështu duke i shkaktuar dëme materiale, fakt ky që vërtetohet edhe nga deklaratat e të paditurit të parë të dhënë në cilësi të të dyshuarit me 06.09.2016 pranë Prokurorisë Themelore në Ferizaj.

Tutje nuk ishte kontestues fakti se ndaj të paditurit të parë, ishte zhvilluar procedurë penale lidhur me dyshimet për kryerjen e veprës penale “Dëmtim i Pronës” së paditësit, fakt ky që vërtetohet nga kallëzimi penal nr. 2016- CF-1949 dt.18.10.2016, e po ashtu nuk është kontestues fakti se Prokuroria Themelore në Ferizaj, 2017 ka pushuar në tërësi hetimet ndaj të paditurit për faktin se nuk është vërtetuar se veprën penale të lartcekur e ka kryer me dashje, fakt ky që vërtetohet me aktvendimin Ferizaj PP/II.nr.1894-5/16 i datës 02.11.2017.

Kontestuese mes palëve ndërgjyqëse ishte baza juridike e kërkesëpadisë, konkretisht fakti se a kanë legjitimitet real pasiv palët e paditura në procedurë, kjo pasi që e paditura e parë ka

pretenduar se për dëmin e shkaktuar nga i njëjti, përgjegjës do duhej mbajtur punëdhënësi i tij i cili nuk është paditur në këtë procedurë, ndërsa sipas të paditurës së dytë, me asnjë provë nuk është vërtetuar se automjeti që ka shkaktuar aksidentin, ka qenë i siguruar tek e paditura.

Nga provat tjera të administruara në këtë procedurë gjyqësore, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike:

Nga raporti fillestar i incidentit 2016/CF-1949 dt.18.08.2016 konstatohet se pronari i paditësit, me datë 17.06.2016, në ora 14:00, është paraqitur pranë stacionit policor në Ferizaj, duke dhënë dëshmi lidhur me dëmtimin e pronës së tij, ashtu që i njëjti ka theksuar se “rreth orës 14:00, një kamion me lartësi të madhe ka goditur reklamën Eli-Ab, ku e ka dëmtuar këtë reklamë, vlera e secilës arrin rreth 1,000.00 EUR. Sa kemi mundur të marrim, firma ka qenë “Euro-Fisi”, Fabrika e Stiroporit, këtë informacion e ka dhënë një dëshmitar”.

Nga fatura e lëshuar nga Urban Sing Sh.p.k. e datës 07.12.2017, konstatohet se ndaj këtu paditësit Eli-Ab është lëshuar faturë me nr. 32 në vlerë prej 1,687.40 EUR lidhur me shërbimet “reklamë ndriçuese dy anësore 120x600” dhe “konstrukcion i çelikut 500x50x50 - 2 copë”.

Nga kopja e urdhërpagesës pranë Pro Credit Bank, konstatohet se paditësi me datë 07.12.2017 ka ekzekutuar pagesën prej 850 EUR, ndërsa me datë 01.02.2018, ka ekzekutuar pagesën prej 837.40 EUR ndaj kompanisë Urban Sing Sh.P.K., lidhur me faturën nr..32.

Nga certifikata e regjistrimit të automjetit 1024633 konstatohet se kompania N.P.T “Euro-Fisi” është pronare e automjetit MAN, tipi S, L 2000, me nr. te tabelave ... dhe me nr. të shasisë

Nga konfirmimi i sigurimit i lëshuar nga e paditura KS Scardian dt.03.09.2019 konstatohet se e paditura e dytë, kompania e sigurimeve Scardian, ka konfirmuar se ka siguruar automjetin e klientit NPT “Euro Fisi” i tipit L 2000 MAN, me nr. te tabelave ... dhe me nr. të shasisë ..., dhe atë për periudhën kohore nga data 25.04.2016 e deri më datë 25.04.2017.

Nga kontrata e punës e datës 01.06.2016, gjykata vërtetoi faktin se i padituri i parë B.P., është i punësuar tek kompania Euro Fisi SH.P.K., që nga data 01.06.2016 dhe atë për periudhë të pacaktuar, në pozitën e punës “Vozitës”.

3. Baza ligjore

Meqenëse raporti juridik mes palëve ndërgjyqëse është krijuar në vitin 2016, për vendosje në këtë çështje juridike kontestimore gjykata iu referua Ligjit 04/L-077 mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të vitit 2012 (tutje si LMD).

Me nenin 136 të LMD-së, përcaktohet se *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*. Ndërsa, me nenin 152 të këtij ligji, është përcaktuar që *“Personi juridik ose fizik me të cilin punonjësi ka punuar në kohën e shkakimit të dëmit është përgjegjës për dëmin e shkaktuar ndaj personit të tretë nga punonjësi gjatë punës apo në lidhje me punën, përveç nëse provohet se punonjësi ka vepruar ashtu siç ka qenë e nevojshme në rrethanat konkrete”*.

Referuar dispozitave të lartcekura, për të ekzistuar përgjegjësia e punëdhënësit për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga punonjësi duhet plotësuar këto kushte kumulative: që dëmi të shkaktohet nga punëtori i punëdhënësit dhe që fakti dëmtues të shkaktohet gjatë punës apo në lidhjen e punës. Pra, kjo formë e përgjegjësisë paraqet përgjegjësi objektive ndaj punëdhënësit, dhe e cila përgjegjësi mund të ekzistoj nëse konstatohet përgjegjësia subjektive e punëmarrësit.

4. Vlerësimi përfundimtar i Gjykatës

Nga gjendja faktike e vërtetuar në rastin konkret, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit ndaj të paditurit të parë B.P. është e pabazuar kjo për faktin se në kohën e shkakimit të dëmit material në pronën e paditësit me datë 17.08.2016, i padituri i parë ka qenë i punësuar tek subjekti “Euro-Fisi” Sh.P.K., dhe atë në pozitën Vozitës, fakt këtë të cilin gjykata e vërtetoi nga kontrata e punës e datës 01.06.2016, ndërsa dëmin tek paditësi e ka shkaktuar me automjetin pronë e subjektit “Euro-Fisi” Sh.P.K., fakt ky jo kontestues mes palëve ndërgjyqëse. Rrjedhimisht rezulton se i padituri i parë, dëmin e shkaktuar përmes goditjes me automjet të reklamës “Eli-Ab” e ka bërë me rastin e ushtrimit të detyrave të punës së tij, kjo për faktin se i njëjti me pozitë ka qenë “Vozitës”, ndërsa dëmin e ka shkaktuar gjatë orarit të punës si dhe me mjetin kryesor të tij të punës, atë të automjetit. Nga këto të gjetura, gjykata erdhi në përfundim se legjitimitet real pasiv për dëmin e shkaktuar me datë 17.08.2016 nuk ka i padituri i parë B.P., por punëdhënësi i tij, i cili nuk rezulton të jetë i paditur në rastin konkret.

Në anën tjetër, gjykata gjeti se për dëmin e shkaktuar me datë 17.08.2016 nuk mund të mbahet personalisht përgjegjës as vet i padituri i parë pasi që referuar 152 par.2 të LMD-së me të cilin se *“Pala e dëmtuar ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit drejtpërdrejt nga punonjësi në rast se dëmin e ka shkaktuar me dashje”* rezulton se paditësi si palë e dëmtuar, ka mundur të

kërkoj shpërblimin e dëmit nga punonjësi, në këtë rast i padituri i parë B.P., vetëm në rast se ky i fundit, dëmin e ka shkaktuar me dashje. Në këtë drejtim, nga provat e administruara në këtë çështje gjyqësore, konkretisht nga aktvendimi PP/II.nr.1894-5/16 i datës 02.11.2017 i lëshuar nga Prokuroria Themelore në Ferizaj, rezulton se hetimet ndaj të paditurit të parë janë pushuar, pasi që nuk është vërtetuar elementi i dashjes së të paditurit të parë, në kryerjen e veprës penale “Dëmtim i Pronës” ndaj këtu paditësit, ndërsa ekzistimi i dashjes së të paditurit të parë në shkaktimin e dëmit ndaj paditësit, nuk është vërtetuar me asnjë provë tjetër të administruar në këtë procedurë.

Gjykata gjeti se ndaj të paditurit të parë B.P., nuk mund të aplikohet as përgjegjësia objektive, ashtu që i njëjti të përgjigjet për dëmin e shkaktuar si zotërues i automjetit në kohën e shkaktimit të aksidentit ashtu siç përcaktohet me nenin 154 të LMD-së i cili rregullon se “*Për dëmin nga sendi i rrezikshëm përgjigjet zotëruesi i saj, kurse për dëmin nga veprimtaria e rrezikshme përgjigjet personi që merret me të*”. Deri tek ky vlerësim gjykata erdhi pasi që përkundër faktit që automjeti në lëvizje konsiderohet si send i rrezikshëm, në rastin konkret, i padituri i parë, nuk konsiderohet të jetë zotërues i automjetit me të cilin është shkaktuar dëmi tek paditësi pasi që i njëjti, përveç që nuk ka qenë pronar i automjetit nuk ka qenë as posedues i automjetit, kjo pasi që automjetin me të cilin i padituri i parë e ka shkaktuar dëmin, ka qenë duke e përdorur për interes dhe për llogari të punëdhënësit të tij “Euro-Fisi” Sh.P.K.

Pra, duke qenë shfrytëzuar automjetin për kryerjen e detyrave të punës dhe për llogari të punëdhënësit e tij, i padituri i parë nuk ka qenë posedues i automjetit por detendor i posedimit, ashtu siç përcaktohet me nenin 105 të Ligjit nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore i cili përcakton se “*Në qoftë se një person e ushtron pushtet faktik mbi një send për ndonjë person tjetër ose për biznesin e ndonjë personi tjetër apo në ndonjë raport të ngjashëm, në kuadër të cilave personi duhet t’i përgjigjet udhëzimeve të tjetrit rreth sendit, atëherë ai nuk është posedues*”

Andaj, në rastin konkret nuk vie në shprehje aplikimi i dispozitës nga neni 157 par.1 i LMD-së i cili parasheh se “*Në vend të pronarit të sendit, dhe njësojë si ai, përgjigjet personi të cilit pronari ia ka besuar sendin që të shërbehet me te, ose personi i cili përndryshe e ka për detyrë ta mbikëqyrë, ndërsa nuk ndodhet në punë te ai*” meqenëse i padituri i parë nuk ka qenë posedues i tërthortë i automjetit, konkretisht i njëjti nuk është shërbyer me automjetin për kryerjen e detyrave personale të tij, por ka qenë vetëm detendor i posedimit.

Në anën tjetër, gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditësit nuk ka mbështetje as në raport me të paditurën e dytë KS Scardian, kjo pasi që nga provat tjera të administruara në këtë shqyrtim gjyqësor dhe atë nga Aktvendimi i Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1894-5/16 i datës 02.11.2017, kallëzimi penal nr. 2016- CF-1949 dt.18.10.2016, procesverbali i deklarimit të të dyshuarit – te paditurit të parë i datës 06.09.2016 dhe raporti fillestar i incidentit 201/CF-1949 dt.18.08.2016, në asnjërin prej tyre, nuk është arritur të identifikohet saktë se me cilin automjet pronë e subjektit “Euro-Fisi” Sh.P.K., është shkaktuar dëmi material më datë 17.08.2016 në pronën e paditësit, kjo pasi që asnjërin nga këto prova, nuk është identifikuar automjeti me numrin identifikues të tij (numrin e shasisë) apo qoftë edhe me tabelat e regjistrimit të tij, por vetëm është identifikuar emërtimi i subjektit “Euro-Fisi” Sh.P.K në pjesën e jashtme të automjetit.

Në këtë drejtim, gjykata gjen se procedurën penale të zhvilluar ndaj të dyshuarit, këtu të paditurit të parë B.P., nuk janë qartësuar mjaftueshëm rrethanat se cili mjet motorik konkret i subjektit “Euro-Fisi” Sh.P.K., ka qenë në përdorim nga i padituri i parë me rastin e shkaktimit të dëmit tek paditësi.

Rrjedhimisht, fakti se e paditura e dytë ka qenë siguruese e automjetit pronë e NPT “Euro Fisi” i tipit L 2000 MAN, me nr. te tabelave ... dhe me nr. të shasisë ..., fakt ky që vërtetohet nga konfirmimi i të paditurës i datës 03.03.2019, nuk e vërteton faktin vendimtar në këtë çështje kontestimore, se a ka qenë pikërisht ky automjet i cili ka qenë në përdorim nga i padituri i parë me rastin e shkaktimit të demit tek paditësi. Kësisoj, referuar nenit 322 par.2 të LPK-së i cili përcakton se *“Pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër”* rezulton se paditësi, nuk ka ofruar prova të mjaftueshme për të vërtetuar faktin vendimtar në raport me ekzistimin e përgjegjësisë së të paditurës së dytë KS Scardian, konkretisht faktin se automjeti i siguruar tek kjo kompani, është automjeti me të cilin është shkaktuar dëmi material në ngjarjen e datës 17.08.2016.

Andaj, duke aplikuar rregullat mbi barrën e provës nga neni 321 par.1 i LPK-së i cili parasheh se *“Në qoftë se gjykata në bazë të provave të marra (neni 8 i këtij ligji) nuk mund të konstatojë me siguri ndonjë fakt, për ekzistimin e faktit do të përfundojë duke i aplikuar rregullat mbi barrën e provës”*, u vendos si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, që kërkesëpadia e paditësit edhe ndaj të paditurës së dytë, të refuzohet si e pabazuar.

Meqenëse nga provat e administruara në këtë shqyrtim gjyqësor, nuk është arritur të vërtetohet legjitimiteti real pasiv i palëve të paditura në këtë procedurë, gjykata, përmes aktvendimit të dhënë në seancën e datës 24.04.2024, ka refuzuar propozimin e paditësit për marrjen e provës me ekspertizë nga lëmia e komunikacionit, kjo për faktin se në rastin konkret, marrja e kësaj prove, përveç që eventualisht do të sqaronte rrethanat se si ka ardhur deri tek aksidenti i datës 17.08.2016, nuk do të vërtetonte fakti vendimtar në raport me ekzistimin e përgjegjësisë së të paditurit të parë, atë të elementit të dashjes në shkaktimin e aksidentit, rrethanë kjo që është sqaruar në procedurën penale sipas aktvendimit PP/II.nr.1894-5/16 i datës 02.11.2017, e po ashtu nuk do arrihej të vërtetohej se cili ka qenë automjeti i kompanisë “Euro-Fisi” Sh.P.K. me të cilin është shkaktuar aksidenti, kjo në mungesë të provave nga Policia e Kosovës për identifikimin e automjetit.

Gjykata pati parasysh edhe pretendimet tjera të të paditurës së dytë se kërkesëpadia ndaj saj është përfshirë në parashkrim, por meqenëse në rastin konkret rezulton se e paditura e dytë nuk ka legjitimitet real pasiv në procedurë, atëherë vlerësimi i prapësimit material të parashkrimit nuk ndikon në vendosjen ndryshe si nga dispozitivi i këtij aktgjykimi.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi në mbështetje të nenit 450 në ndërlidhje me nenin 452 të LPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë, në bazë të nenit 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr. 2594/22, datë 07.05.2024

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.